



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË  
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM  
Nr.320, datë 20.08.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME  
DELVINË SH.A.

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 20.08.2021 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit "Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Delvinë sh.a.",

**Vëren se:**

1. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Delvinë (**UK Delvinë**) me shkresën nr. Prot. 137 prot., datë 19.07.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Delvinë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 63 datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" (**VKM nr. 63**).
3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

- a) Shoqëria UK Delvinë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 16 783 banorë të Bashkisë Delvinë ;
  - b) Drejtues teknik i shoqërisë z. Vani Toti është diplomuar në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e inxhinierisë dega Hidroteknike në vitin 1986;
4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Delvinë, të:
- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficientë, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
  - b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (**ligji nr. 9121**) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Delvinë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

### **VENDOSI:**

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Delvinë sh.a me (NUIS K46909504W), në kategoritë:
  - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik
  - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura
2. Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Delvinë sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
  - a) Drejtues Ligjor – Vasil Marga
  - b) Drejtues Teknik – Vani Toti
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Delvinë sh.a është Bashkia Delvinë .
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Delvinë sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Delvinë sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**

**Ndriçim Shani**